



# Termat e Referencës për Angazhimin e Koordinatorit kryesor të programit "Shahu në Shkolla".

**Titulli i projektit:** Shahu në Shkolla - Integrimi i sportit të shahut në sistemin arsimor të Kosovës  
**Klienti:** Federata e Shahut e Kosovës (FSHK).

## 1. SFONDI:

Federata e Shahut të Kosovës (FSHK) në kuadër të programit shtetëror "Shahu në Shkolla" është e përkushtuar që të integrojë sportin, veçanërisht shahun, në kuadër të sistemit arsimor në Kosovë. Për të arritur këtë objektiv, FSHK kërkon të krijoj mekanizmat e nevojshëm të zbatimit të aktiviteteve dhe koordinimit në mes të gjithë akterëve të përfshirë në këtë aktivitet, siq janë: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), Drejtorit Komunale të Arsimit (DKA), Federatën e Sportit Shkollor të Kosovës (FSSHK) dhe Federatën e Shahut të Kosovës (FSHK). Qëllimi kryesor i kësaj thirrje është rekrutimi i instruktorëve regjional të cilët do të kontribuojnë në koordinimin dhe harmonizimin e të gjitha aktiviteteve të programit.

## 2. OBJEKTIVAT:

Objektivat kryesore të këtij angazhimi janë:

- **Identifikimi i sfidave në integrimin e plotë të sportit të shahut në sistemin arsimor në Kosovë:** Të shqyrtohen sfidat ekzistuese lidhur me politikat publike, kapaciteteve fizike, financiare dhe njerëzore në integrimin e plotë të aktiviteteve sportive, me theks të veçant shahun, si aktivitete kurrikulare apo jashtëkurrikulare në sistemin e arsimit fillor;
- **Zhvillimi i një plan-programi për palët e ndryshme të interesit për integrimin e plotë të shahut në sistemin arsimor në Kosovë:** Zhvillimi i një plan-programi për veprimet që duhet të ndërmerren në nivel të kornizës programore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA) dhe Federatave Sportive (Federata e Sportit Shkollor dhe Federata e Shahut e Kosovës) në ndërtimin e kapaciteteve profesionale në nivel menaxherial dhe operacional për zbatimin e programit "Shahu në Shkolla".
- **Bashkëpunimi ndërinstytucional:** Të bashkëpunojë me ekspertë lokal dhe ndërkombëtarë në kuadër të Federatës së Shahut të Kosovës për udhëzime mbi praktikën më të mira dhe rekomandime kombëtare dhe ndërkombëtare që kanë të bëjnë me integrimin e shahut në shkolla.

## 3. PALËT E INTERESIT:

- Institucionet qendrore përkatëse (MASHTI dhe MKRS);
- Institucionet lokale përkatëse (DKA);
- Shkollat e përzgjedhura;
- Federata e Sportit Shkollor të Kosovës (FSSHK), dhe
- Federata e Shahut e Kosovës (FSHK);

#### **4. FUSHA E PUNËS:**

Fusha e punës përfshinë aktivitetet e mëposhtme:

Përgjegjësia e Koordinatorit kryesor të programit “Sporti në Shkolla” qëndron në sigurimin e zbatimit të programit dhe monitorimit e situatës në terren, si dhe në krijimin e bashkëpunimit mes grupeve të interesit të ndryshme, institucioneve arsimore, MKRS-së, FSSHK-së dhe FSHK-së.

#### **4.1 Detyrat dhe Koordinimi i ekipit të koordinatorëve rajonal:**

*Sigurimi i mbarëvajtjes së projektit:*

*Pika e kontaktit ndërmjet FSHK-së dhe grupeve të tjera të interesit:*

*Koordinimi i koordinatorëve rajonal:* Organizimi i takimeve të rregullta me Instruktorët regjional në analizimin e zbatimit të programit “Shahu në Shkolla”;

*Asistimi i koordinatorëve rajonal:*

Asistimi koordinatorëve rajonal në aktivitetet regjionale;

Asistimi në organizimin e aktiviteteve extra-kurrikulare.

#### **4.2 Organizimi i aktiviteteve dhe zbatimi i plan-programit “Shahu në Shkolla”:**

*Aftësimi dhe trajnimi i koordinatorëve rajonal:* Organizimi i trajnimit të koordinatorëve rajonal në demonstrimin dhe aplikimin e programit “Shahu në shkolla”.

*Asistimi i koordinatorëve rajonal në furnizimin e shkollave me pajisje dhe material promovues sipas nevojës:* Asistimi koordinatorëve rajonal në furnizimin e shkollave me pajisjet e nevojshme në zbatimin e programit, mirëmbajtja e pajisjeve dhe materialeve të ofruara nga FSHK.

*Krijimi i një plani dinamik të veprimit:* Krijimi një plani dinamik të veprimit për hapat që koordinatorët rajonal dhe shkollat me stafin e saj duhet të ndërmarrin për jetësimin e programit në plotni. Ky plani i veprimit duhet të shërbejë si një udhërrëfyes praktik për zbatimin e rekomandimeve, duke siguruar që ato të zbatohen në mënyrë efektive.

#### **4.3 Shfrytëzimi i ekspertizës lokale dhe ndërkombëtare:**

*Bashkëpunimi me ekspertë lokal dhe ndërkombëtarë:* Bashkëpunim i ngushtë me ekspertë lokal dhe ndërkombëtarë përmes Federatës së Shahut të Kosovës, të shfrytëzohen njohuritë dhe përvojat e tyre në fushën e integritimit sportiv në arsim për të informuar dhe pasuruar kërkimet, analizat dhe rekomandimet. Ekspertiza e tyre do të kontribuojë në zhvillimin e një qasjeje të mirëinformuar dhe të harmonizuar globalisht për integrimin e sportit të shahut në Shkollat e Kosovës.

#### **4.4 Monitorimi dhe raportimi:**

Monitorimi i koordinatorëve rajonal në zbatimin e aktiviteteve në shkolla dhe raportimi periodik tek FSSHK dhe FSHK. Raportet narrative përfshijnë punën regjionale të të gjitha shkollave dhe punës së koordinatorëve rajonal.

Raportimi në FSHK dhe FSSHK për progresin dhe punën.

Raportimi në FSHK dhe FSSHK sipas kërkesave për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me projektin.

#### **4.5 Rekomandime dhe sygjerime:**

Koordinatori kryesor në bashkëpunim me koordinatorët rajonal bazuar në të dhënat nga terreni dhe sfidat e zbatimit të programit duke përfshirë specifikat regjionale dhe burimet njerëzore të kyqura në proces do të ofrojnë ekspertizën e tyre duke ofruar rekomandimet dhe sygjerimet për MASHTI-ne, MKRS-ne, FSSHK-ne dhe FSHK-ne për përmirësimet e nevojshme.

## **5. KUALIFIKIMET E KOORDINATORIT TË PROGRAMIT:**

Koordinatori kryesor i angazhuar për këtë projekt duhet të ketë këto kualifikime:

- Përvojë e dëshmuar minimum pesë vjeçare pune me nxënësit në fushën e sportit;
- Të ketë të përfunduar shkollimin universitar (studimet bachelor/master në fakultetin e edukimit fizik, menaxhim ose fusha të ngjashme);
- Njohuri të thella të rregulloreve të sportit të shahut në Kosovë.
- Licenca ndërkombëtare nga FIDE ose ECU për zhvillimin e shahut;
- Përvojë në kryerjen e hulumtimeve dhe analizave në fushën e arsimit dhe sportit.
- Aftësi të forta analitike dhe shkrimore.
- Njohja me parimet dhe praktikat e shahut është një plus.
- Një kuptim i thellë i kontekstit lokal të Kosovës, duke përfshirë nuancat kulturore, sociale dhe arsimore.
- Aftësi të forta të menaxhimit, duke përfshirë aftësinë për të koordinuar dhe menaxhuar në mënyrë efektive palët dhe burimet e ndryshme të interesit;
- Njohuri pune të programeve standarde të Office (Word, Excel, Power Point);
- Njohuri të shkëlqyera të gjuhës shqipe, gjuha angleze dhe serbe janë të preferueshme.

## **6. AKTIVITETET QË DUHET ZBATUAR:**

Koordinatori kryesor pritet të zbatojë aktivitetet si në vijim:

- Koordinimin e aktiviteteve të programit në nivelin regjional të përfshirjes në mes të: DKA, shkollave të përzgjedhura, mësimdhënësve të angazhuar, instruktoreve regjional dhe MASHTI, MKRS, FSSHK dhe FSHK;
- Monitorimi dhe raportimi i vijueshmerisë së aktiviteteve dhe plan programit në regjionet përkatëse tek FSSHK dhe FSHK;
- Përgaditja e planit dinamik të zbatimit të programit “shahu në shkolla” në bashkëpunim me Koordinatorët rajonal, stafin e DKA, shkollave të përzgjedhura dhe mësimdhënësve të angazhuar;
- Pjesëmarrja në takimet e punës;
- Metodologjia e punës.
- Kryerja e detyrave të ndryshme të lidhura me punën e caktuar;

## **7. AFATI KOHOR:**

Angazhimi pritet të përfundojë brenda periudhës kohore prej dy vjete me mundësi vazhdimi.

## **8. BUXHETI:**

Buxheti për këtë angazhim duke përfshirë të gjitha shpenzimet do të definohet me rastin e nënshkrimit të kontratave të bashkëpunimit në mes të institucioneve relevante (FSSHK-s) dhe pozicionit të Koordinatorit të programit.

## 9. DORËZIMI I PROPOZIMEVE:

Koordinatorët e interesuar ftohen të dorëzojnë aplikimet e tyre në:

**Federata e shahut e Kosoves <fshekosoves@gmail.com> ose <info@shahu-rks.com>** deri në **30.10.2023**, me dokumentet mbështetëse, si vijon:

**Letër motivuese:** Një letër e shkurtër motivuese që shpreh interesin për projektin dhe nënvizon përvojën tuaj përkatëse.

**Curriculum Vitae (CV):** Një CV e detajuar që përshkruan arsimin, përvojën profesionale, publikimet (nëse ka) dhe çdo informacion tjetër përkatës.

**Trajnime dhe Licencat:** Një listë e trajnimeve të mëparshme në lidhje me politikën arsimore, integrimin sportiv ose zhvillimin e sportit të shahut. Licenca ose certifikata eventuale të marra nga FIDE/ECU ose FSHK për zbatimin e programeve të shahut.

**Përvoja në sportin e shahut:** Dëshmi në aktivitetin e sportit të shahut përmes regjistrimit në klube të shahut në Kosovë, pjesëmarrje në gara zyrtare të shahut në Kosovë, etj.

## 10. KRITETERT E VLERËSIMIT:

Propozimet do të vlerësohen në bazë të kriterëve të mëposhtme:

- Ekspertiza dhe kualifikimet e aplikuesit;
- Licenca të FIDE/ECU (obligative);
- Anëtarësia në FSHK/Klube të shahut në Kosovë (obligative).

## 11. KONTAKTI:

Për pyetje dhe paraqitjen e propozimeve, ju lutemi kontaktoni:

*Burhan Misini*

[fshekosoves@gmail.com](mailto:fshekosoves@gmail.com)

+383 46 120 790